

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“KODUZI CAR RENTAL” SH.P.K.

Sot, më date **30.01.2023**, une i nënshtkruari:

- **Anis Koduzi** lindur me 23/07/1997, ne Lushnje dhe me rezidence ne Lushnje, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr.**034570913**, madher me zotesi te plote juridike per te vepruar....; ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**KODUZI CAR RENTAL**” SH.P.K. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshtkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: “**KODUZI CAR RENTAL**” SH.P.K.

Neni 2

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Fier, Lushnje, Lagja Cliriri, pasuri nr 4/61 Zk 8571 9001** .

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime kontaktimi elektronik është si vijon:

Shoqëria ka te drejte te hapë cëge apo filiale ne te gjithë territore e Republikës se Shqipërisë.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillën qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- a. Import – Export te autovegurave te reja dhe te perdorura.Tregtimi i autovegurave te reja dhe te perdorura. Dhenie makina me qera, etje.

-Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njqind mije) Lekë

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Anis Koduzi** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100 000** (njqind mije) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund të bëhet vetëm pasi Asambleja e ortakëve me shumicë e ka dekretuar këtë dhe për më tepër të gjithë ortakët janë të detyruar që ta repektojnë dhe të kontribuojnë në para ose në natyrë në bazë të vendimit të shumicës së asamblese

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen përmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes; (me të drejtën e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, por nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të transferueshme me rrugë trashgimie.



Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve, përjashtimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimmarrës përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë emërohet z. **Anis Koduzi** lindur me 23/07/1997, në Lushnjë dhe me rezidence në Lushnjë, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet leterajofitimit nr. **034570913**, madhor me zotesi të plote juridike për të vepruar, i zgjedhur për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të përcaktuara qartë në statutin e shoqërisë.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjithësisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të përcaktuara në Aktin e Shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në Njeshitë IX të Ligjit 950 të datës 14.01.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË

ANIS KODUZI

Anis Koduzi

